

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Qerim Ademaj dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Kompania e Sigurimeve “NN”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim M.A. nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve ”Sigal”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim Sokol Dardha nga Prishtinë, për rimbursim mbi bazën e subrogimit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëse e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.211/16 e datës 24/11/2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **08/08/2019**, mori këtë:

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** e pa themeltë ankesa e paditëses Kompania e Sigurimeve ”NN”, me seli në Prishtinë dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike III.EK.nr.211/16 e datës 24/11/2017.

### **A r s y e t i m**

Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin ankimor III.EK.nr.211/16 e datës 24/11/2017, në piken I të dispozitivit ka vendosur që të refuzohet në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve ”Sigal”, me seli në Prishtinë, që paditëses t’ia kompensoj mjetet në emër të borxhit shumë prej 7,560.00 euro, me kamatë ndëshkuese prej 12 %, në vit duke llogaritur nga dita e dërgimit të kërkesës për rimbursim, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afatin partitiv prej 7 ditëve, duke llogaritur nga data e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim, ndërsa në piken II të dispozitivit ka vendosur që secila palë të bartë shpenzimet e procedurës kontestimore veç e veç.

Kundër këtij aktgjykimi, paditësja në afatin ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimin e ankimuar të prishë dhe lëndën ta kthej gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe vendosje apo të ndryshoj aktgjykimin dhe të aprovtoj kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar.

E paditura ka dhënë përgjigje në ankesë duke propozuar që të refuzohet në tërësi si e pabazuar ankesa e paditëses dhe të vërtetohet aktgjykimi i atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, dhe 200 të LPK-së, ka gjetur se:

#### **-Ankesa është e pa themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Kompania e Sigurimeve "NN" me seli në Prishtinë, pran Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 13/04/2016, ka paraqitur padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Sigal", me seli në Prishtinë, që paditëses t'ia rimbursoj mjetet në emër të kompensimit të dëmit material në shumë prej 7,560.00 euro, me kamatë ndëshkuese prej 12 %, duke filluar nga dita e dërgimit të kërkesës për rimbursim të mjeteve e deri në pagesën definitive si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore. Nga referati i padisë rezulton se me datën 01/06/2015, ka ndodhur aksident trafiku në Fushë Kosovë, ku ishin përfshirë automjeti i udhëtarëve i markës "MCO1", me targa të regjistrimit ..... i siguruar te e paditura dhe automjetit i udhëtareve "BMW", me targa ....., i siguruar te paditësja, ashtu që deri te aksidenti ka ardhur me fajin e drejtuesit të automjetit "MCO1", me targa të regjistrimit .... i cili duke mos i respektuar rregullat e komunikacionit e godet automjetin e të siguruarit të paditëses dhe i shkakton dëme materiale. Paditësja në ndërkohë ia kompenson demin të siguruarit të saj në shumë prej 7,560.00 euro, andaj nga këto arsye ka kërkuar mbrojtje gjyqësore.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë, me datën 01/11/2016, ka marr aktvendim me të cilën e ka detyruar të paditurën, që në afat prej 7 ditësh të përgjigjet në padinë e paditëses. E paditura Kompania e Sigurimeve "Sigal", me seli në Prishtinë, në afatin ligjore ka paraqitur përgjigje në padi, duke e kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetim se me të siguruarin e paditëses K.A., me datën 16/06/2015 ka lidhur marrëveshje jashtë gjyqësore për demin material. Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën 30/10/2017, në cilësinë e dëshmitarit e ka dëgjuar të siguruarin e paditëses K.A., i cili mes tjerash ka deklaruar se nga dy kompanitë e sigurimeve e kam realizuar demin dhe nuk me kujtohet se a i kam njoftuar paditësen se e kam realizuar kompensimin e demit edhe nga e paditura, andaj pas administrimit të provave gjykata e shkallës së parë e vendos si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 136, nenin 962 par.2 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e ka marr konform nenit 452.2 lidhur me nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Apelit e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes ka gjetur se gjykata e shkallës së parë duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses duke gjetur se e njëjta është e pabazuar. Aktgjykimi i goditur nuk është i përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat kjo Gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare. Në arsyetimin e aktgjykimit të goditur janë dhënë arsye të duhura faktike dhe juridike dhe arsye mbi të gjitha faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejt të kësaj çështje juridike të cilat janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë. Parashtrimet në ankese nuk e vejnë në pyetje ligjshmërinë e aktgjykimit të goditur. Gjykata e Apelit po ashtu vlerëson se aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta që kishin me ndikuar në ligjshmërinë e saj lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale. Kjo Gjykatë e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik dhe konstatimin faktik të gjykatës së shkallës së parë, ku vërtetohet se i siguruari i paditëses Kastriot Avdija, me datën 16/06/2015 ka lidhur marrëveshje jashtë gjyqësore me të paditurën Kompania e Sigurimeve “Sigal” me seli në Prishtinë, duke deklaruar se *“me kryerjen e riparimit të mjetit, unë nuk kam asnjë pretendim të mëtejshëm financiar ndaj të paditurës, dhe me pranimin e kësaj shume përmbushen plotësisht dhe përfundimisht pretendimet ndaj paditëse lidhur me demin material”*, ndërsa e paditura me datën 07/08/2015 ia ka kompensuar demin të siguruarit të paditëses në vlerë prej 1,709.00 dhe me këtë rast i siguruari i paditëses dhe e paditura detyrimet e tyre i kanë shuar me marrëveshje ashtu siç parashihet me nenin 8 par.2 të LMD-së: *Detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullneteve të pjesëmarrësve në marrëdhënien e detyrimeve ose në bazë të ligjit*, andaj në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për rimbursim të dëmit sipas nenit 960 të LMD-së, në raport me të paditurën, pasi që i siguruari i paditëses e ka realizuar të drejtën e tij pranë të paditurës dhe ka hequr dorë nga të gjitha të drejtat tjera dhe i njëjti nuk mund që të bart një kërkesë juridike inekzistente te paditësja, ndërsa nga shkresat e lëndës nuk rezulton se i siguruari i paditëses e ka njoftuar paditësen se kompensimin e dëmit e ka realizuar nga e paditura dhe i njëjti nuk ka të drejtë që për të njëjtin rast të kompensohet dy herë, ndërsa nga marrëveshja jashtëgjyqësore e lidhur me të paditurën, nuk rezulton se kompensimi i dëmit ka qenë i

pjesshëm, por kompensimi i dëmit të automjetit është bërë në tërësi ashtu siç janë dakorduar palët.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike duke dhënë arsye të mjaftueshme, ndërsa pretendimet e paditëses janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjyimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjyimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata e Apelit.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 195 paragrafi 1 pika (d) dhe 200 të LPK-së.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**-Departamenti për Çështje Ekonomike-**

**Ae.nr.1/18, me datën 08/08/2019**

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari  
Liridon Maloku, d.v